

12 MAJ
2026

TIRANË, SHQIPËRI

KONFERENCA E PROFESIONISTËVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Të nderuar kolegë,

Kam nderin dhe kënaqësinë t'ju ftoj në një event shkencor dhe profesional kushtuar edukimit dhe zhvillimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale, i cili do të zhvillohet më 12 Maj 2026, në Hotel Plaza, Tiranë.

Ky event synon të bashkojë profesionistë të kujdesit shëndetësor nga fusha të ndryshme, përfshirë infermierë, mami, mjekë, akademikë, drejtues institucionesh shëndetësore, studentë dhe profesionistë të rinj, për të ndarë njohuri, përvoja dhe qasje inovative në edukimin dhe praktikën shëndetësore. Në qendër të diskutimeve do të jetë transformimi digjital i edukimit dhe praktikës shëndetësore, duke eksploruar rolin e teknologjisë shëndetësore, realitetit virtual dhe inteligjencës artificiale në rritjen e kompetencave profesionale, përmirësimin e vendimmarrjes klinike dhe garantimin e sigurisë së pacientit.

Sot, profesionistët e shëndetit përballen me sfida gjithnjë e më komplekse, të cilat kërkojnë edukim të vazhdueshëm, përshtatje me teknologjitë e reja dhe përdorim të praktikave të bazuara në evidencë shkencore. Ky event synon të ofrojë një platformë reflektimi, diskutimi dhe bashkëpunimi ndërdisiplinor për të adresuar këto sfida. Përmes sesioneve plenare, paneleve të diskutimit, prezantimeve shkencore dhe shembujve praktikë, do të trajtohen tema kyçe që lidhen me edukimin profesional, kujdesin shëndetësor cilësor, shëndetin mendor të profesionistëve, lidhësinë, si dhe integrimin e teknologjive digjitale në shërbimet shëndetësore.

Ky event përfaqëson një hapësirë dialogu profesional, rritjeje akademike dhe fuqizimi institucional, duke promovuar bashkëpunimin mes profesioneve shëndetësore për një sistem shëndetësor më të fortë, më të sigurt dhe më efikas. Ju ftojme me kënaqësi të na bashkoheni në Tiranë për një event frymëzues, bashkëkohor dhe të pasur me njohuri, që synon të kontribuojë në formësimin e së ardhmes së edukimit dhe praktikës shëndetësore në Shqipëri.

Me respekt
Blerina Duka
President UISH



TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN:

Edukimi dhe zhvillimi profesional

- Edukimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në epokën digjitale
- Modele bashkëkohore të edukimit të vazhdueshëm profesional
- Simulimi klinik si mjet edukimi dhe vlerësimi profesional
- Realiteti virtual dhe realiteti i shtuar në edukimin shëndetësor
- Mësim-nxënia hibride dhe platformat digjitale në shëndetësi

Teknologjia dhe inovacioni në shëndetësi

- Inteligjenca Artificiale në praktikën klinike dhe edukim
- Teknologjitë digjitale për sigurinë e pacientit
- Telemedicina dhe kujdesi shëndetësor në distancë
- Sistemet elektronike të dokumentimit dhe reduktimi i barrës administrative
- Shëndetësia digjitale dhe transformimi i shërbimeve shëndetësore

Praktika klinike dhe cilësia e kujdesit

- Kujdesi shëndetësor i bazuar në evidencë
- Standardet e cilësisë dhe sigurisë së pacientit
- Menaxhimi i rasteve komplekse dhe patologjive bashkëshoqëruese
- Vendimmarrja klinike në situata emergjente dhe kritike
- Kujdesi i përqendruar te pacienti dhe familja
- Parandalimi i gabimeve klinike dhe kultura e sigurisë

Shëndeti mendor dhe mirëqenia e profesionistëve

- Stresi profesional dhe burnout në profesionet shëndetësore
- Strategjitë për rritjen e reziliencës profesionale
- Mbështetja e shëndetit mendor në mjediset klinike
- Etika profesionale dhe distresi moral
- Balanca punë-jetë dhe mirëqenia në vendin e punës



TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN:

Lidershipi, menaxhimi dhe politika shëndetësore

- Lidershipi klinik dhe menaxherial në shëndetësi
- Menaxhimi i burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor
- Politikat shëndetësore dhe ndikimi i tyre në praktikën klinike
- Roli i drejtuesve në transformimin digjital të shëndetësisë
- Siguria ligjore dhe përgjegjësia profesionale

Qasje ndërdisiplinare dhe shëndeti global

- Bashkëpunimi ndërprofesional në kujdesin shëndetësor
- Shëndeti global dhe sfidat bashkëkohore
- Promovimi i shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve
- Barazia dhe aksesueshmëria në shërbimet shëndetësore
- Inovacionet në shëndetin publik

E ardhmja e profesioneve shëndetësore

- Profili i profesionistit shëndetësor të së ardhmes
- Aftësitë digjitale dhe kompetencat e reja profesionale
- Integrimi i teknologjisë pa humbur humanizmin në kujdes
- Etika dhe sfidat e inteligjencës artificiale në shëndetësi
- Roli i edukimit në përgatitjen për sistemet shëndetësore të së nesërmes.



KUSH MUND TË MARRË PJESË?

Ky aktivitet u drejtohet të gjithë profesionistëve të kujdesit shëndetësor, si infermierë, mami, fizioterapistë, teknikë imazherie, teknikë laborator, si dhe logopedë. Thirrja është e hapur për profesionistë akademikë, punonjës klinikë, studiues, si edhe për studentë të këtyre profileve.

PËRSE DUHET TË MERRNI PJESË?

Pjesëmarrja në Kongresin e Kujdesit Shëndetësor Digjital ju jep mundësinë të përditësoni njohuritë dhe aftësitë tuaja me risitë më të fundit në edukimin digjital, inteligjencën artificiale dhe realitetin virtual.

Ju do të kuptoni mënyrën se si teknologjia po transformon edukimin, praktikën klinike dhe sigurinë e pacientit, përmes shembujve konkretë të përdorimit të AI dhe VR në trajnimin e profesionistëve të shëndetit, si dhe prezantimeve mbi simulimin klinik, mësimin virtual dhe platformat digjitale për zhvillim profesional.

Kongresi ofron mundësi për të ndarë praktikat më të mira dhe përvojat reale, si dhe për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë e transformimit digjital. Ai krijon lidhje me profesionistë, edukatorë, drejtues dhe inovatorë, duke hapur rrugë për bashkëpunim akademik, klinik dhe teknologjik.

Pjesëmarrësit gjithashtu do të diskutojnë etikën, sigurinë dhe përgjegjësinë profesionale në përdorimin e teknologjisë, duke kuptuar më mirë rolin e tyre në epokën e AI dhe teknologjive digjitale.

Sesionet shkencore dhe edukative të strukturuar, si dhe certifikata e pjesëmarrjes me kredite për edukim të vazhdueshëm profesional, ofrojnë një përvojë gjithëpërfshirëse.

Ky kongres është një mundësi frymëzuese për të mësuar nga praktikat inovative dhe ekspertët e fushës, dhe për të fuqizuar rolin tuaj në ndërtimin e një sistemi modern, të sigurt dhe human të kujdesit shëndetësor.



NJOFTIME TË RËNDËSISHME



Afati përfundimtar i dorëzimit të abstrakteve

28 Mars 2026



Njoftimi i pranimit të abstrakteve

Do të bëhet në rrugë elektronike



Regjistrimi i pjesëmarrësve

Online dhe fizikisht pranë Hotel Plaza



Dërgimi me email

events@urdhriinfermierit.org



UDHËZIME PËR DORËZIMIN E ABSTRAKTEVE

Abstrakte

Abstraktet duhet të dorëzohen shqip dhe në anglisht. Gjatësia e abstraktit duhet të jetë 250-300 fjalë dhe duhet të zërë një faqe të vetme. Duhet të përmbajë titullin e punimit, emrat e autorëve, adresën postare dhe të email-it events@urdhriinfirmierit.org

Pranimi i abstrakteve

Do të njoftohet në rrugë elektronike **brenda datës 10 Prill 2026.**

Bashkëngjitjet e nevojshme

1. CV e autorit/autorëve korrespondentë.
2. Të dhënat e kontaktit të autorit korrespondent për komunikim: emër dhe mbiemër, profesioni, adresa, vendi i punës, telefon, e-mail.

Deklarata

- Plotëso KËTU deklaratën e konfliktit të interesit

Formati i abstraktit

- Format: Word
- Shkrimi: Times New Roman 12
- Paragrafi: Single
- Orientimi: Justified
- Hapësira midis rreshtave: 1.5

Struktura e abstraktit

- **Titulli:** Me shkronja kapitale, bold, paragrafi centered
- **Autorët:** Listohen sipas kontributit në punim
- **Seksionet e përmbajtjes:**
 1. Hyrja
 2. Objektivat
 3. Metodologjia
 4. Rezultatet
 5. Konkluzionet
- **Fjalët kyçe:** 4-5 fjalë

Referencat

5-10 vitet e fundit